

Rregullat e garancisë së zgjatur

Termtat e kontratës – Zgjatimi i garancisë 3-vjeçare të BOSCH brenda shtrirjes së fushatës së shitjeve “**Bosch Exclusiv: 5 vite pa shqetësime.**”, i cili zgjat nga 16 Janari 2020 deri në 15 Janar 2021. Fushata e shitjeve zbatohet për lavatricet Bosch Exclusiv dhe tharëset.

Ofruesi i garancisë:

*BSH Hišni aparati d.o.o. Nazarje
Savinjska cesta 30, 3331 Nazarje
Republika e Sllovenisë*

Termtat e mëposhtëm që tregojnë kushtet dhe shtrirjen e garancisë sonë të zgjatur nuk ndikon në detyrimet statutore të shitësit për garancinë sipas kontratës së shitjeve të nënshkruar me klientin final.

1. Shtrirja e termave të kontratës

1.1. Gjatë periudhës së garancisë së zgjatur, teknikët e shërbimit të kontratës të BSH Hišni aparati d.o.o. Nazarje, Savinjska cesta 30, 3331 Nazarje, Republika e Sllovenisë (i referuar nga këtu e tutje si “BOSCH”) do të riparojë falas defektet e provuara në material dhe/ose defektet e pajisjes në prodhim të treguara në certifikatën e garancisë nëse BOSCH është njoftuar për to menjëherë pas zbulimit dhe gjatë periudhës së vlefshmërisë së garancisë së zgjatur.

1.2. Shërbimi i garancisë kryhet me anë të riparimeve gjatë periudhës së garancisë, p.sh. me riparimin ose ndërrimin e pjesëve me vendim të BOSCH. Nëse një riparim i caktuar del se është i pamundur ose i paarsyeshëm ekonomikisht, BOSCH do të vendosë nëse pajisja duhet ndërruar ose jo në vend se të riparohet brenda periudhës së garancisë. Pjesët e ndërruara, si edhe pajisjet e ndërruara, do të bëhen pronë e BOSCH.

1.3. Shërbimi i garancisë, subjekt i pikës 1.4, përfshin kohën e punës, mbërritjen dhe nisjen, materialet e këmbimit dhe produktet e pastrimit, si edhe këshilla nga tekniku i shërbimit në lidhje me eliminimin e shqetësimeve të klientit dhe administrimin.

1.4. Nëse eliminimi i defektit nuk bie brenda mbulimit të garancisë dhe klienti mund të ketë qenë në dijeni të kësaj, atëherë të gjitha shpenzimet e hasura gjatë kontrollit, në veçanti kostot e vizitave të shërbimit, do të tarifohen përveç nëse klienti mund të vërtetojë se nuk mund ta ketë ditur që pretendimi për garancinë do të ishte i pavlefshëm duke marrë parasysh rrethanat.

1.5. Garancia e zgjatur zbatohet vetëm për pajisjen e treguar në certifikatë dhe nuk mund të transferohet në një pajisje tjetër.

1.6. Garancia e zgjatur është e vlefshme vetëm në territorin e Shqipërisë, për produktet e blera nga konsumatorët (personat fizikë) në Shqipëri nga entet ligjore të regjistruara në Shqipëri.

1.7. Shërbimet nën garancinë e zgjatur mund të kërkohen pas paraqitjes së një certifikate të vlefshme së bashku me faturën (duke treguar datën e blerjes dhe/ose dërgesës).

2. Kohëzgjatja dhe transferimi i garancisë

2.1. Garancia e zgjatur do të merret përsipër nga BOSCH menjëherë pas një garancie dy-vjeçare për shërbimet e treguara në pikën 1, për një periudhë prej 3 vjetësh. Kontrata do të mbarojë automatikisht pas 3 vjetësh dhe nuk ka nevojë të anulohet.

2.2. Shërbimet e kryera të garancisë nuk ndikojnë në zgjatjen e periudhës së garancisë, as nuk rinovon periudhën e garancisë për të filluar një të re, përveç rasteve të përcaktuara me ligj.

2.3. Nëse pajisja ndërrohet brenda periudhës së garancisë brenda kuptimit të fjalise nr. 2 të pikës 1.2, certifikata origjinale do të humbasë vlefshmërinë e saj. Periudha e mbetur e garancisë i transferohet pajisjes zëvendësuese për të cilën lëshohet një certifikatë përkatëse e re.

2.4. Kur pajisja shitet, certifikata që zbatohet për pajisjen mund t'i transferohet pronarit të ri. Kjo nuk ndikon në termtat kontraktuale të garancisë së zgjatur e cila do të mbetet në fuqi dhe do t'i transferohet pronarit të ri në një formë të pandryshuar. Në këtë rast, periudha e garancisë nuk do të zgjatet më tej dhe as nuk do të zgjatet për të filluar një të re.

3. Shërbimet që përjashtohen dhe mbyllja e garancisë

3.1. Garancia e zgjatur e BOSCH nuk përfshin garancitë në rastet e mëposhtme:

- Nëse klienti nuk i është përmbajtur udhëzimeve të shoqëruara për përdorimin e produktit;
- Nëse produkti është modifikuar nga një person pa autorizimin e prodhuesit,
- Nëse klienti e ka trajtuar produktin në mënyrë të papërshtatshme.

BOSCH nuk do të jetë përgjegjës për dëmtimet e shkaktuara gjatë transportit pas dërgesës së produktit, për defektet që vijnë për shkak të instalimit ose mirëmbajtjes së papërshtatshme, për dëmtimet mekanike të shkaktuara nga përdoruesi, për defektet që vijnë për shkak të tensionit shumë të ulët ose shumë të lartë ose mungesës së ujit dhe për shkak të atyre që vijnë nga forcat madhore.

BOSCH nuk do të jetë përgjegjës për dëmtimet e shkaktuara gjatë transportit pas dërgesës së produktit, për defektet që vijnë për shkak të instalimit ose mirëmbajtjes së papërshtatshme, për dëmtimet mekanike të shkaktuara nga përdoruesi, për defektet që vijnë për shkak të tensionit shumë të ulët ose shumë të lartë ose mungesës së ujit dhe për shkak të atyre që vijnë nga forcat madhore.

4. Marrja e garancisë së zgjatur

4.1. Blini një lavatrice ose tharëse nga linja Bosch Exclusiv nga 16 Janari 2020 deri në 15 Janar 2021 dhe regjistrojeni në <http://promovime.al.bosch-home.com> brenda 30 ditësh nga data e blerjes së pajisjes, klienti merr një zgjatim promocional 3-vjeçar të garancisë.

5. Garancia

5.1. Kërkesat që kalojnë shtrirjen e garancisë së zgjatur ose kërkesat e tjera – në veçanti ato që lidhen me kompensimin për dëmtimet që ndodhin jashtë pajisjes – nuk mbështeten nga kjo garanci e zgjatur.

6. Adresimi i një çështjeje garancie

6.1. Shërbimet e riparimit bëhen gjatë orarit të punës të autorizuar nga teknikët e shërbimit të BOSCH.

6.2. Kur kërkoni një riparim garancie, klienti duhet të japë informacionet e treguara në etiketën e të dhënave. Informacione të mëtejshme mbi etiketën e të dhënave dhe vendin e saj në pajisje mund të gjenden në udhëzimet e përdorimit ose në <http://promovime.al.bosch-home.com>

6.3. Klienti do të përgatitë certifikatën dhe faturën origjinale për teknikun e shërbimit të autorizuar në ditën e riparimit.

7. Masat e tjera

7.1. Këto kushte zbatohen vetëm për garancinë ekstra të BOSCH brenda shtrirjes së fushatës së shitjeve lavatricet dhe tharëset Bosch Exclusiv e cila zgjat nga 16 Janari 2020 deri në 15 Janar 2021.

7.2. Masat ligjore që devijojnë ose janë në kundërshtim ose ndryshojnë këtë garanci të zgjatur do të jenë të vlefshme vetëm nëse janë bërë me shkrim.

7.3. Marrëdhënia kontraktuale midis BOSCH dhe klientit do të drejtohet nga ligji shloven.

7.4. Juridiksioni për çdo mosmarrëveshje midis BOSCH dhe klientit do të përcaktohet nga vendbanimi i klientit. Klienti ka të drejtën të nisë procedura ligjore kundër BOSCH para një gjykate sipas zyrës së regjistruar të tij.

Janar 2020